

U D H Ë Z I M
Nr.34, datë 12.5.2001

**PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NË FORCAT E ARMATOSURA
DHE NË FORCAT E RENDIT**

Për realizimin e të drejtës së votës të zgjedhësve në Forcat e Armatosura dhe në Forcat e Rendit për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të 24 qershorit 2001, në mbështetje të nenit 60 dhe 104 pika 1 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Ministria e Mbrojtjes dhe Minsitria e Rendit Publik, përmes komandave të njësive e reparteve në vartësi, organizojnë punën për hartimin e listës së zgjedhësve që në datën e zgjedhjeve do të ndodhet në repartin përkatës, sipas formularit bashkëlidhur.

Për realizimin e këtij detyrimi ligjor do të procedohet:

1. Oficerët dhe nënoficerët që janë të punësuar, si rregull, regjistrohen dhe votojnë si gjithë shtetasit e tjerë në vendbanimin e përhershëm të tyre, së bashku me familjen. Për këtë kategori votuesish, komanda përkatëse harton grafikun e shërbimit në mënyrë që, krahas kryerjes së detyrës funksionale, t’u krijojë mundësi për të ushtuar të drejtën e votës, brenda orës 8.00 deri 18.00 të ditës së votimit.

2. Ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, si dhe oficerët apo nënoficerët e karrierës që banojnë në repart (që janë me vendqëndrim) dhe në ditën e zgjedhjeve do të jenë në repart regjistruar në listën e zgjedhësve të repartit, duke plotësuar për çdo zgjedhës me germa kapitale, saktësisht sipas të dhënave të certifikatës së lindjes, gjithë të dhënat që kërkon modeli i listës, që shoqëron këtë udhëzim.

Lista firmoset dhe vuloset veças në çdo faqe nga komandanti i repartit dhe shefi i personelit dhe, brenda datës 22.5.2001 ora 12.00 me një shkresë përcjellëse, në të cilën përcaktohet edhe numri i përgjithshëm i votuesve në listë, dorëzohet në Komisionin e Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore të bashkisë apo komunës, brenda territorit të së cilës ka vendndodhjen repartit, nga shefi i personelit të repartit, kundrejt një procesverballi, firmosur nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZQV-së.

3. Kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZQV-së, marrin kontakt me kryetarin e bashkisë apo komunës dhe, së bashku, përcaktojnë qendrën e votimit që është më afër repartit dhe ku do të votojnë zgjedhësit e listës përkatëse.

Numri i qendrës së votimit shënohet në krye të çdo faqeje të listës së ardhur nga repartit dhe, përkrah saj, vendoset vula e KZQV-së.

4. KZQV-ja, listën e repartit, brenda datës 25.05.2001 ora 12.00, e dorëzon doras me proceverbal tek supervizori i KQZ-së në prefekturën përkatëse, i cili, në datën 26.5.2001, e dorëzon në Drejtorinë e Regjistrimit Kombëtar të Zgjedhësve.

5. Drejtoria e Regjistrimit Kombëtar të Zgjedhësve, këta zgjedhës i përfshin në listën përfundimtare të KZZ-së ku ka vendndodhjen repartit dhe i heq nga listat e zgjedhësve të vendbanimit përkatës.

6. Komandat e reparteve duhet t’i bëjnë të qartë dhe t’i krijojnë mundësi çdo zgjedhësi të përfshirë në këto lista, që, ditën e votimit, do të lejohen të votojnë, vetëm nëse do të paraqesin në komisionin e qendrës së votimit një nga këto dokumente: certifikatë lindjeje me fotografi, letër njoftimi, pasaportë për jashtë shtetit, kartën e votuesit, si dhe librezë ushtarake.

Ditën e zgjedhjeve, në orën 7.30, komanda e repartit dorëzon në KQV edhe një listë të zgjedhësve ushtarë.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Ilirian Celibashi